



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 09, datë 16.10.2017

PËR

MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT TË INFRASTRUKTURËS PËR OBJEKTIN:
“REHABILITIMI I RRUGËS SË LUMIT TË VLORËS, AKSI SELENICË-KUÇ-
QEPARO, BASHKIA VLORË, HIMARË DHE SELENICË”

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr.519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të Fondit Shqiptar të Zhvillimit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit të Infrastrukturës: “Rehabilitimi i Rrugës së Lumit të Vlorës, Aksi Selenicë-Kuç-Qeparo”, me subjekt zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumentet e Lejeve të Ndërtimit të Infrastrukturës i jepen subjektit kërkues sipas segmenteve të poshtëshënuara:
 - “Selenicë – Peshkëpi”;
 - “Vlorë - Peshkëpi”;
 - “Peshkepi – Gjorm”;
 - “Ura e Gjormit – Brataj”;
 - “Brataj – Ura e Laskos”;
 - “Ura e Laskos – Kuç”;
 - “Ura e Laskos – Qafa e Mbretes”;
 - “Qafa e Mbretes – Ura e Kudhësit”;
 - “Ura e Kudhësit – Qeparo”.

vetëm pas:

- a) miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për pasuritë e shpronësuar.
- b) miratimit të vlerësimit të ndikimit në mjedis për gjithë segmentet dhe miratimit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë;

c) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Vlorë, Himarë dhe Selenicë.

4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

